

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI⁴¹, mbledhja e 11) me dt.29.10.2020 (e enjte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Statutit të Ansambllit të këngëve dhe valleve Obiliq
4. Shqyrtimi i raportit financiar janar-shtator 2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së për transfer dhe rialokim të mjeteve
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08 e dt.16.11.2011
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.09.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës dhe drejtorët komunal, Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planifikimit të Buxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet për vitet 2022 dhe 2023
4. Dhënia në diskutim publik e Projekt Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës
5. Dhënia në diskutim publik e Projekt Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike
6. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08, të dt.16.11.2011
7. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për dhënienn në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK LLazarevë:
 - a) N.T.SH."Tre"
 - b) N.SH."A.M.C.
 - c) Kompania kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – SH.A. KEDS
 - d) N.T.SH."DIARI"
 - e) Bermas Therm SH.P.K.
 - f) Bimer Group SH.P.K.
 - g) A-D-E Group SH.P.K.
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Fatos Kurshumlija – Propozon që pika e 6 shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së, për themelimin e Komisionit për shqyrtimin e lëndës C.nr.847/08, të dt.16.11.2011, të hiqet nga rendi i ditës me arsyen se kjo lëndë është ende në proces gjyqësor dhe ende nuk ka përfunduar.

Lulzim Sadiku – Edhe unë e kam të njejtën kërkesë sepse ne si grup dhe unë personalisht nuk kemi të dhëna as me shkrim, as për lëndën e cila është, për shqyrtim, C.nr.847/08, të dt.16.11.2011. Prandaj, pasi që nuk e kemi materialin dhe nuk kemi të dhëna të sakta propozoj që të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës dhe të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Aziz Bici – Rreth kërkesës së parafolësve për tërheqjen e pikës së rendit të ditës kam pyetje se qysh flitet lidhur me kërkesën e Kryetarit të Komunës për shqyrtimin e vendimit të Gjykatës themelore në Prishtinë si dhe urdhërit përmbarrimor. Unë mendoj se këto vendime e kanë materialin, e kanë lëndën dhe pse nuk na ka ardhë, nuk e di. Si pyetje, unë sigurisht se do ta japë një kontribut timin se ky Komision që ne do ta formojmë, a ka kompetenca me i shqyrtue vendimet e Gjykatave dhe të përmbarrimit.

Naim Miftari– Propozimi për formimin e këtij Komisioni për shqyrtimin e lëndës vjen duke u bazuar në aktgjykimin e Gjykatës themelore në Prishtinë Cnr.847/08. i cili thotë se e paditura Komuna e Obiliqit, organi i saj Kuvendi komunal, obligohet që të bëjë emërimin e një Komisioni të ri, në të cilin Komision nuk duhet të jetë i përfshirë anëtarë i mëparë deri në ndarjen e sërishme të banesave me qira për 10 vite. Duke u bazuar në dispozitat e nenit 86 të Statutit të Komunës, neni 6 dhe 7 i Ligjit për parandalimin e konfliktit administrativ, ashtu që në procedurë të detyrueshme të rindarjes ti evidentoj të gjitha shkeljet dhe vlerësimet e rindarjes së banesave konform kritereve të përcaktuara. Kërkoj që të formohet ky Komision nga Kuvendi dhe administrata komunale, kështu që pas përfundimit të punës gjithsesi ky Komision të sjellë një raport në Kuvend.

Armend Rushiti – Edhe unë jam i mendimit që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër.

Nazmi Gashi – Ne mund ta shtyejmë këtë pikë të rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme, por ne patjetër duhet ta zgjidhim këtë rast sepse është kërkesë e Gjykatës. Ne nuk kemi çka të fshehim, jemi transparentë dhe besoj se Komisioni do ta kompeltoj lëndën dhe do ta japë arsyetimin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan rendin e ditës me ndryshimin që pika e 6 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Shqyrtimin e Planifikimit të Buxhetit për vitin 2021 dhe parashikimet për vitet 2022 dhe 2023.

Zarife Behluli – Sipas Qarkores së 3 buxhetore të hyrat vetanake për vitin 2021 janë 950,180 €, grandi i përgjithshëm është 2,232,502 €, granti specifik i Arsimit është 2,600,591 €, granti specifik për shëndetësi është 807,703 €, total granti është 5,640,796 €. Mjetet nga Ligji për Obiliqin për vitin 2021, i kemi 4 milion e 600 dhe planifikimet për vitin 2022 dhe 2023, njejtë megjithëse, këto sipas Ligjit të Obiliqit, mund të ndryshojnë varësisht nga shitja e thëngjillit.Total buxheti për vitin 2021 është 11,190,796 €, për vitin 2022 është 12,547,143 €, dhe për vitin 2023 është 12,731,737 €. Tani, këtë buxhet e ndajmë në 5 kategori ekonomike dhe për vitin 2021 paga dhe medijtje janë 4,273,658 €, mallra dhe shërbime 993,930 €, shpenzime komunale 316,675 €, subvencione dhe transfere 830,000 €, shpenzime kapitale 4,776,533 €.

Pastaj, drejtoresha i njoftoi më gjerësisht të pranishmit me buxhetin për të gjitha Drejtoritë komunale.

Lulzim Sadiku – Është fat i mirë që Komuna e Obiliqit, ka një buxhet të tillë për të cilin po flasim sot dhe është për ti falenderuar të gjithë ata që kanë punuar pa bërë politikë edhe LB-në, edhe LDK-në, Kryetarin dhe të gjithë ata që kanë punuar në këtë drejtim. Sot jemi duke e shpërndarë buxhetin nëpër vija që në fakt nëse, e specifikojmë besoj se shumë gjëra do të kryhen për vitin 2021, ndërsa për vitin 2022 do të shohim se kush do të udhëheqë dhe si do të veprojnë. Unë isha në takimin për ndarjen e buxhetit dhe vërtetë, është bërë një analizë e thukët në bashkëpunim me anëtarët e Kuvendit dhe drejtorët, që dikund jemi pajtue, e dikund nuk jemi pajtue. Ajo që më preokupon është se Kryetari ka kërkuar me i specifikue gjërat pak më mirë dhe

kur them me i specifikue gjërat pak më mirë është fjala te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit. Ne jemi marrë vesh në mënyrën më të mirë se ku do të bëjmë këto parqe sepse edhe kërkesat e atyre, që nuk kanë qenë me siguri se do të ishin shumë më të lehta dhe shumë më të përgjithshme. Mirëpo, kjo fatkeqësisht nuk është bërë. Ne kemi biseduar për çështje të rrugëve, sa që edhe më heret kur kemi bisedue për buxhetin, mendoj se është punuar deri në ora 24 dhe e kemi bërë një listë për rrugët që janë me prioritet. Edhe kjo nuk është bërë edhe pse Kryetari iu ka thënë drejtorëve, atë ditë që me i specifikue dhe me i sjellë. Ne jemi arsyetue me qëllim që me ditë ku jemi për ato rrugë që i kemi specifikue më heret, por për shkak të tenderimit që me ditë se cilat rrugë me i përfshi, mos me i specifikue me një kod buxhetor, por nuk janë kryer. Te planifikimi mjedisor kam menduar me bë një ndryshim shumë të vogël që besoj se do të pajtoheni. Te rregullimi i parqeve në Komunën e Obiliqit, janë ndarë 180,000 €. Ne kemi biseduar dhe e kemi rritë këtë shifër nga 150,000 në 180,000 dhe nga kjo shifër prej 180,000 €, kërkoj që të ndahet në 170,000 €. Ne kemi biseduar edhe më heret se Komuna e Obiliqit, ka nevojë për një morg ose kapellë sepse po kemi problem me njerëzit që i kemi jashtë dhe atëherë, kemi biseduar që të jetë brenda oborrit të xhamisë. Pra, është biseduar është ndarë buxheti, por ka shkue në drejtim tjetër nëse, nuk gaboje në vitin 2016, prandaj kërkoj këto 10,000 euro, të ndahen dhe të shkojnë në vijën buxhetore sepse besoj se është e arsyeshme dhe e domosdoshme. Te blerja e veturave, drejtoresha e shëndetësisë ka kërkuar me ble një veturë të re për nevojat e shëndetësisë dhe konkretisht për shkak të asistencës sociale. Deri tash janë ndarë 15,000 €, ndërsa tash është një vlerë prej 20,000 €. Unë kam mendue se kanë qenë 15,000 €, por nëse janë 20,000 €, unë tërhiqem dhe nuk është problem. Te ndërtimi dhe renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore janë ndarë 120,000 €, që mendoj se gati është një pikë e përbashkët me shtatorët në Obiliq, që këtu nuk e kemi ndarë asnjë buxhet. Propozoj që për shtatorët në Obiliq, të ndahen 10,000 €, sepse aty ka gjithë nevojë për investime të vogla dhe të mbeten 110,000 €, te ndërtimi dhe renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, ndërsa 10,000 €, të shkojnë te shtatorët në Obiliq. Këtu, nuk e kemi të specifikuar. Te Drejtoria e Arsimit renovimi i shkollave, blerja e pajisjeve 200,000 €, dhe këtu nëse, mendojmë për çështjen e rregullimit të kabineteve me pajisje, Kryetari ka thënë se do të bashkëpunoj dhe të marrë prej KEK-ut, grant për rregullimin e çështjes së kabineteve. Te investimet kapitale, këto janë konkretisht ashtu qysh kemi bisedue. Te sheshi "Adem Preniqi" vlera e sheshit a po përputhet me atë që është dhënë në vitin 2019, sepse po duket në vitin 2019 për vitin 2020 nga se kemi ndarë buxhet dhe për vlerën për të cilën po flasim 616,928 €. Tash, me buxhetin që kemi pasë më heret po delë më duket vlera më e madhe se qysh e kemi cekë për vitin 2020 me buxhetin e kaluar. Dua, të specifikohet çështja e listës së rrugëve në mënyrë që të dijmë se ku jemi me rrugët në vitin 2021, çështjen e rregullimit të parqeve jemi marrë vesh ku është më e nevojshme dhe i kemi cekë disa nga ato si dhe rregullimi i fushave sportive me na dhënë sqarim për këto fusha sportive. Vërtetë. nëse këto i kemi të specifikuar dhe na i sjellni të dhënat e sakta do ta votoj me grupin e PDK-së, buxhetin, e nëse jo vërtetë po mbetemi gjithmonë të paarsyeshëm për gjërat që Kryetari ka premtue se do të vijnë në mbledhjen e Kuvendit.

Aziz Bici – Ne si Komunë e vogël kemi një buxhet shumë të madh dhe mendoj se me këtë buxhet nuk është duke u bërë një ndryshim i cili kishte mund me qenë në Komunën tonë. Te mallrat, po e shohë se furnizimi me lule, kurora shuma është 4,000 €, për vitin 2021, që aktualisht një buqetë e mesme me lule të freskëta ishte 10 €, dhe në rast se ne e pjesëtojmë 4,000 €, me 10, është 400 €, buqeta me lule. Tash, nëse, ne i krahasojmë datat përkujtimore të dëshmorëve, festave që mund të shkojmë me i bë nderime, mendoj prapë se është një shumë që nuk është dashtë dhe nuk e di qysh e keni marrë parasysh shumën prej 4,000 €. Furnizimi me ujë dhe gota 5,000 €, mendoj se është një shumë mjaft e madhe. Te mirëmbajtja e parqeve 70,000 €, nuk e kam parë se janë ndarë mjete për ujëtimin e drunjëve të mbjellura afër rrugës. Mendoj se për shkak të mosujtjes edhe drunjët nuk po zhvillohen sepse nuk është veç me thënë ti mbjellim dhe të mbeten ashtu drunjët. Telefon mobil 16,000 €, mendoj se janë shumë sepse 5 €, është oferta INT M, që mundesh me folë tërë muajin qoftë në internet, qoftë në telefon. Në rast se e pjesëtojmë me 5, delë 3,200 oferta, në rast se

e pjesëtojmë me 12,000 janë 266 zyrtarë që munden me i pasë këto oferta. Derivate për vetura 53,000 €, një pyetje e kam se sa automjete janë në përdorim të Komunës dhe më duket se është shpenzim i madh dreka zyrtare 13,000 €, gjithahшту mendoj se është një shumë e madhe e ndarë për dreka. Mirëmbajtja e veturave për vitin 2021, 15,000 €, çka përfshihet gjithë kjo shumë e mjeteve për me u bë mirëmbajtja. Unë prapë po them nuk e di numrin e shfrytëzuar të automjeteve të Komunës, që ndoshta, është e arsyeshme por duhet të dihet se për çka po përdoren këto vetura, nga cilët zyrtarë. Te investimet kapitale shkruan se bashkëfinancim shuma është prej 270,000 €, nuk e ka projekti emrin që nuk e kuptoj për çka është fjala me këto mjete prej 270,000 €, si bashkëfinancim. Unë nuk e kam parë se janë ndarë mjete për ujësjellës sepse mendoj se ende nuk ka përfunduar ujësjellësi në Komunën tonë dhe nuk e di sa janë të mjetueshme edhe për kanalizim. Në fshatin Bakshi ka ankesa dhe ende ankohen banorët se kanalizimi ende nuk është përfunduar. Unë jam kundër prapë nga se vazhdoni me 12 Drejtori komunale dhe mendoj se jo vetëm ne të Vetëvendosjes, por edhe gjithë këta anëtarë të Kuvendit komunal që nuk e kanë me interes me Kryetarin e Komunës, nuk është dashur me votue këtë buxhet me këto 12 Drejtori komunale, sepse vërtetë është e ngarkuar.

Dragan Dancetovic – Është fjala për një buxhet madhor dhe të punuar mirë dhe unë do të doja që më shumë me këtë buxhet të përfshihen komunitetet pakicë sepse ekzistojnë disa probleme në infrastrukturë te komunitetet pakicë të cilat nuk janë zgjidhur dhe pres që në vitin e ardhshëm një sasi e vogël e tyre të zgjidhet. Këtu, fjala është për rrugë, kanalizim dhe ujësjellës.

Nazmi Gashi – Ne kemi debatuar 2 ditë pune dhe është një kërkesë për të gjithë kolegët që herave tjera, të na bashkangjiten. Kjo që po diskutohet tani, ne çdo shifër dhe çdo detal e kemi shqyrtue. Mendoj se ka pasë arsyeshmëri të plotë që kemi qenë, vetëm ishte mangut që nuk kemi qenë më konkret dhe më shumë pjesëmarrës anëtarë të Kuvendit. Është një Kuvend për lavdi, që nuk është vetëm rezultat i Ekzekutivit, por edhe rezultat i joni, do të thotë se një përkrahje e singertë prej neve është një shtytje dhe ndihmë e madhe edhe për Ekzekutivin. Unë besoj se në vitin 2021, infrastruktura e rrugëve, kanalizimeve dhe ujësjellësit do të përfundoj. Unë kam mendue të ndahet një buxhet fillestar për formimin e ndërmarrjeve komunale, që neve na mungon sepse me përfundimin e infrastrukturës vjen në shprehje mirëmbajtja, që është pjesë shumë me rëndësi e kësaj që po punohet sot.

Hysni Mjeku – Unë flas në emër të anëtarit të KPF-së dhe ne i kemi dhënë përparësi këtij buxheti për vitin 2021, sepse vërtetë i plotëson shumicën e kushteve për qytetarët e Komunës së Obiliqit. Pas takimit punues dhe debatit publik e kemi shqyrtuar edhe në KPF, në mënyrë analitike dhe sintetike dhe kemi konstatuar se vërtetë ka shumë për të punuar, por mbi të gjitha ky buxhet i plotëson deri dikund ku shtet për tu aprovuar. Obiliqi, ka nevojë për shumë parqe, për fusha sportive, kanalizime, ujësjellës, por mbi të gjitha duhet të rritet buxheti. Ne kemi konstatuar mundësisht parqet, fushat sportive edhe te kogjenerimi edhe pse është një projekt madhor i Komunës së Obiliqit, unë e di që kushton shumë, por besoj se do të ia daslim nëse vërtetë si Kuvend punojmë dhe veprojmë ashtu siç na ka hije, jo pse ky, apo ai e tha këtë, por nëse është në interesin e qytetarëve duhet të aprovohet. Unë ju sugjeroj anëtarëve të Kuvendit, që kur janë takimet me rëndësi të veçantë të marrin pjesë dhe të japin mendimin e vet, e jo vetëm ta marrin fjalën në Kuvend, sa për ta marrë minotazhën të cilën unë e konsideroj si kohë të humbur. Mbi të gjitha, është dashur që në këto takime të marrin pjesë shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe të merret edhe opinioni i qytetarëve, që unë nuk e përjashtoj as veten sepse në disa takime nuk kam marrë pjesë, që është një gjë se nuk duhet të vazhdohet me këtë metodë pune sepse nuk mund të kemi rezultate.

Kryetari – Është fat i madh që Obiliqi ka një buxhet dukshëm më të madh për kokë banori se Komunat tjera. Sa i përket çështjes së buxhetit, ju e dini se në kohën e pandemisë disa gjëra, apo disa anëtarë të Kuvendit nuk kanë mund të marrin pjesë në punimin e buxhetit. Mirëpo, mbi të gjitha e falenderoj kryesuesin dhe anëtarët e Kuvendit, që kanë pasë kohë bashkarisht ti përgatitin vijat buxhetore për vitin 2021. Ne kemi biseduar në përbërje të anëtarëve të Kuvendit dhe Ekzekutivit, për projekte të ndryshme, kemi bërë disa ndryshime edhe te buxheti, por ju jeni ata që vendosni për buxhetin 2021, ndërsa ne si Ekzekutiv do të mundohemi me implementue në tërësi. Te çështja e veturave që u përmendë se janë 20,000

€, nuk ka rëndësi ose, mbetet pjesë nga ajo shumë sepse ne prapë e kemi mundësinë e rishikimit Te shtatorët, që u përmendë është kompani, pastaj te mirëmbajtja ne mund ta ndajmë edhe një buxhet të veçantë, por e dijmë se drejtoresha i ka në planifikim, në proces tani për rregullimin e mbishkrimeve dhe korigjimin e të gjitha të tjerave në këtë vit, prandaj, mirëmbajtja do të mbetet pjesë e mëtutjeshme e kompanisë. Sa i përket rrugëve, ato do të vazhdojnë aty ku e kemi nisë dhe që e kemi bërë një planifikim bashkë. Te fushat sportive, i kemi diskutue të gjitha hapësirat e mundshme që nga Grabofci deri në Kozaricë, të krijohen edhe 7 fusha të reja me qëllim që të rinjëve, të ju krijojmë mundësi të kenë fushë sportive në gjithë territorin e Komunës. Parqet, sinqerisht mund të them se i kemi në fokus që ne me pasë sa më shumë parqe dhe jemi munduar në këtë drejtim kudo që kemi hapësira të lira nëpër fshatra të investohet. Te objekti i kogjenerimit, te sheshi “Adem Preniqi” janë 2 kontrata të nënshkrimeve në proces dhe shpresojmë se nisen, ndërsa pjesa tjetër do të vazhdoj në vitin e ardhshëm. Sa i përket luleve, që e përmendi z.Aziz, këto janë të planifikuara dhe është kontratë në vazhdimësi, do të thotë ato që shpenzohen prej mallrave dhe shërbimeve ato edhe paguhen, jo më shumë. Mendoj se ujin të gjithë që e konsumojmë është kjo, drekat dhe darkat mund të them me përgjegjësi se nuk i shjpenzoj mbi 500-600 €, në vit dhe ato shpenzohen prej delegacioneve, prej drejtorëve, prej anëtarëve të Kuvendit dhe sa për mua i heqim krejtë komplet dhe i lejmë në 0. Derivatet janë maksimalisht të ulëta dhe veturat shfrytëzohen kryesisht për punë. Tani, jemi në proces të ndërrimit të veturave dhe besoj se me 5,6 vetura furnizohemi sepse është Prokurimi që e ka udhëheqë në nivelin qëndror që e ka centralizue. Sa i përket investimeve kapitale, i falenderoj sinqerisht anëtarët e Kuvendit dhe Ekzekutivin dhe është shoqëria civile që maksimalisht kanë dhënë kontribut dhe kanë ndarë kohë për këtë buxhet. Vija e bashkëfinancimit, e dini se është e domosdoshme sepse shumë projekte në vazhdimësi Komuna, ka arritë me i marrë prej Ministrive të ndryshme dhe të gjitha janë me bashkëfinancime. Ujësjellësi dhe kanalizimi, përveç KUR “Prishtina” që e ka obligim edhe ne po mundohemi në vazhdimësi me iu ofruë shërbim qytetarëve. Z.Aziz, nuk janë 12 Drejtori, por janë 11. Tani, i përgjegjem z.Dragan se seriozisht ne jemi mundue gjithëherë mos me i dallue pakicë dhe shumicë dhe të gjitha projektet që adresohen në Komunën tonë, do të adresohen te qytetarët e Komunës tonë, pa dallim etnie dhe bindje fetare.

Lulzim Sadiku – Unë kërkova që të jetë edhe një kapellë në buxhet për vitin 2021, në ndërkohë me i heqë mjetet nga rregullimi i parqeve sepse është e nevojshme, do të thotë me marrë përgjegje. Sa i përket çështjes së parqeve dhe fushave sportive, atë ditë këtë e kemi dhënë, por edhe për çështjes e rrugëve kërkoj që të dijmë përafërsisht se ku jemi me rrugë. Ju, Kryetar keni premtuar atë ditë se ke me sjellë listën që të dijmë se ku jemi dhe kur dikush pyet në Hamidi se kur do të shtrohet rr.“Ali Gollaku” me thënë se është në projekt për vitin 2021. Lidhur me morgun thashë se edhe në vitin 2016 kemi diskutuar, e kemi rishikuar buxhetin dhe kërkova me i heqë mjetet nga rregullimi i parqeve sepse është shumë e vogël nëse, aty janë 180,000 €, ajo do të kushton përafërsisht 10,000 €, po paragjykoj se nuk jam i saktë. Mendoj se kë to specifika që i kërkova edhe pse ishte një arsye nga Grabofci deri në Kozaricë, pjesërisht ku ka pjesë tokësore komunale që i kemi shtrure, mendoj se po e lejmë ashtu. Mirëpo, ishte çështja e kapellës, apo morgut dhe mundësisht me na ardhë një listë që ne ta dijmë se cilat rrugë do të shtrohen në vitin 2021.

Aziz Bici - Unë po e marrë fjalën edhe një herë për arsye se dua me ua rikujtue se edhe në Komunën tonë ka njerëz skamnorë, ka njerëz me nevoja shumë të mëdha. Po ashtu, kemi bashkëqytetarë tonë që jetojnë me qira, kemi familje që janë të riatdhesuar dhe ne si Komunë një vit ia kemi paguar qiranë, por pas një viti e kemi hudhë në rrugë. Këtu, ne kemi njerëz të politikës që i shfrytëzojnë banesat sociale, kemi njerëz që i marrin 2,3 rroga, kemi njerëz që zgjedhin edhe punë dhe që doni ua them edhe me emra, që duhet me ua thënë. Në rast se ju mendoni se vërtetë kërkesa ime e kursimit është jo e drejtë, gaboheni rëndë sepse jo rastësisht qytetarët po dojnë me u shpërngulë krejtë. Në rast se juve, iu duket se i keni familjet e juara brenda fshatit, shtëpive, lagjeve dhe vendit të Kosovës, të tjerët, nuk i kanë dhe përgatiten me dalë jashtë. Për këtë arsye ju ftoj edhe njëherë që të kursejmë sa të mundemi, në mënyrë që të ua bëjmë jetën më të lehtë, që njerëzve në nevojë gjërat elementare të ua sigurojmë.

Kryetari -.Së pari i përgjegjem z.Lulzim, dhe e pyes drejtoreshën se a mund ti marrim 10,000 €, nga mallrat dhe shërbimet dhe a mund ti ndajmë 15,999 €, sepse 10,000 €, ndoshta janë pak mjete.

Zarife Behluli - Përgjegjet se sa i përket morgut që e ceku z.Lulzim, mund ti vendos te një vijë buxhetore te DSHPE-ja, veç me i minusu te parqet sepse mallrat dhe shërbimet e kanë të prerë sa munden me pasë mallra, sa shpenzime komunale, sa subvencione dhe sa kapitale. Unë e kam një propozim se në fund të vitit mbetjet që i kemi nëpër projekte, mund ta bëjmë për vitin 2021 një projekt.

Kryetari – Drejtoreshë, pra mund ta përfshini në buxhet, do të thotë 15,000 €, merre në ndonjë vijë nga DSHPE-ja/Sot jemi në votim të buxhetit dhe është fatmirësi se të gjithë kemi pasë mundësi të japim kontribut në projekte apo në shpërndarje të buxhetit. Pajtohem se ne duhet me kursye buxhetin dhe pajtohem se ne duhet me destinue buxhetin, me ditë se ku po e qojmë buxhetin.Sinqerisht ka njerëz që kanë kontribue, por ka edhe njerëz që asnjë vijë nuk e kanë bërë dhe asnjë ide për një projek nuk e kanë sjellë, që nuk e di se qysh kanë me justifikue veten përveç ankesave që bëhen në vazhdimësi.

Aziz Bici – Dihet se unë kam pasë kërkesë, për ndërtimin e shkollës në Baimoc, me sigurie hapësirën për ndërtimin e një fushë sportive sepse ju e dini se aty komuniteti serbë nuk e lejon as për së afërmi me i shfrytëzue ato hapësira.J u e dini se unë kam kërkuar që të ndërtohet një shkollë me standarde në Mazgit dhe është e vërtetë se është duke u punuar, por aneks pas aneksit. Gjithë këto mjete mos me ndërtue një shkollë me standarde vetëm ju e bëni Kryetar, që nuk është mirë dhe jo me thënë vetëm te shikoj hapësirën sepse shkolla duhet me pasë njëfarë pamje. Është e vërtetë se e kemi ndërtue një park të mirë, por është edhe një e vërtetë tjetër, që unë mendoj se kam pasë të drejtë kur të kam thënë mos e prish rrugën Mazgit, në atë segmentin e dytë prej hekurudhe deri te pishat dhe nuk ka qenë koha dhe duhet me u marrë vesh me bashkëfshatarët atje lartë. Tash kemi shumë probleme me këtë rrugë sidomos automjetet e transportit sepse është zënë me trotuar. Trotualet vërtetë, janë shumë të rëndësishëm, por duhet edhe lëvizjet e automjeteve me qenë qysh duhet. Mendoj se nuk duhet me ndërtue vetëm ku i ke aktivitetet e tu, që jam për me i ndërtue edhe ato, por bile kur ua ndërton, kërko në atë vend që të zgjerohet rruga aty.Pra, do të thotë se nuk është se nuk kemi bërë kërkesa, por nuk i ke marrë asnjë parasysh.

Kryetari – Për të gjitha projektet që janë realizue dhe janë në realizim ka pasë debate në secilin fshat, por ti e din a ke qenë apo jo. Sot po e planifikojmë buxhetin, sot po e votojmë buxhetin dhe ne qe një muaj jemi duke u marrë me buxhetin. Ju si anëtarë të Kuvendit e dini se cilat janë detyrat tuaja sepse edhe ju dhe unë këtu, tek e fundit jemi me votën e qytetarëve dhe nuk e di që ke sjellë ndonjë projekt me përfshi në buxhet.

Kryesuesi – Paraqet rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për komunitete të dt.18.09.2020.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për dhe 2 vota kundër e aprovuan Vendimin për Planifikimin e Buxhetit komunal për vitin 2021.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për e aprovuan Vendimin për dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e miratuan Vendimin për dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK LLazarevë: a) N.T.SH.”Tre”.

Kryetari – Ne jemi munduar në vazhdimësi me qenë transparentë sa i përket çështjes së dhënies së pronave në shfrytëzim dhe ne plotësimet i kemi bërë siç janë me vendimin e cekur. Është fatmirësi se të gjithë të interesuarit për prona kanë ardhë dhe e kanë bërë prezentimin e projekteve të tyre. Unë e kam potencuar edhe herave tjera dhe tash po e potencoj se pronat që jepen në shfrytëzim i inicon Kryetari, por këtë të drejtë ia jepë Kuvendi, kështu që është çështje e juaj nëse, ju e vlerësoni edhe ia jepni pronën.

Enver Gashi – Ne i kemi parë prezentimet e të gjithë operatorëve dhe Drejtorisë përkatëse për vlerësimin e të gjitha projekteve, kështu që ne jemi për këta ofertues të përzgjedhur.

Hysni Mjeku – Unë po flas në emër të anëtarit të KPF-së, ne i kemi pasë 2 kalime: hapjen e dyerve për biznese dhe ato biznese, që nuk janë funksionale të iu merret e drejta e shfrytëzimit të pronës. Prandaj, ne në KPF, kemi qenë pro dhe jemi pro këtyre bizneseve.

Fatos Kurshumlija – Mua, nuk më ka ardhë materiali, kjo pjesa shtesë që ka qenë me shumë material dhe as nuk e kam lexue, as s'mund të votoj pro sepse nuk jam në rrjedha rreth dhënies së pronave këtyre bizneseve.

Aziz Bici – Unë do të votoj kundër.

Nora Preniqi – Unë për këtë pikë do të abstenoj.

Nazmi Gashi – Ne do ta japim pronën komunale në shfrytëzim me qëllim të zbatimit të marrëveshjes dhe ata që nuk e zbatojnë e humbin të drejtën.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 1 votë kundër dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë ofertuesi N.T.SH."Tre".

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënienn në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë: b) ofertuesi N.SH. "A.M.C".

Enver Gashi – Ne jemi për sepse këtu, është zhvilluar një prezentim i suksesshëm me asambleistët dhe drejtorët.

Shaip Paloja – Unë kam qenë prezentë gjatë prezentimit të të gjitha këtyre kompanive dhe e falenderoj Kryetarin për ftesën që na ka mundësue ta dëgjojmë secilin ofertues. Në veçanti mua më ka pëlqye A.M.C, një kompani që bën organizimin e evenementeve të ndryshme kulturore në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Një kompani që ka bërë organizimin e evenimentit të Rita Orës, Dua Lipës, ka sjellë një favor shumë të mirë për Komunën tonë, përgatitjen e kuadrove në aspektin kulturor dhe artistic. Mendoj se është shumë e mirë sepse më në fund duhet edhe Komuna të investoj në këto quadro që na përfaqësojnë në nivel ndërkombëtar. Mua, më ka pëlqye shumë sepse ai ia ofroi edhe një reklamë të mirë Obiliqit, me iu bë në nivelin ndërkombëtar, bile 2 salla që ai prezentoj tha se njëra do të quhet Rita 1, dhe tjetra Dua 1. Unë atij i propozova me qenë Rita 1 në Obiliq, që në aspektin ndërkombëtar le të dihet se ai objekt do të jetë në Komunën e Obiliqit. Mendoj se reklamë më të mirë Komunës tonë nuk i ka ndodhë, as nuk ndodhin kurrë këto, vetëm i uroj sukses.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 1 votë kundër dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë ofertuesi N.SH. "A.M.C".

Kryesuesi - Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë: c) kompania kosovare për distribuimin dhe furnizim me energji elektrike, SH.A. KEDS.

Enver Gashi – Ne jemi për këtë propozimvendim.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për atë që të aprovohet ky propozimvendim.

Aziz Bici – Ne do të jemi kundër.

Nora Preniqi – Unë do të abstenoj.

Nazmi Gashi - Unë jam për aprovim.

Shaip Paloja – Ëtë fat i mirë se atë ditë të gjitha prezentimet janë inçizuar. Unë kisha dashur që edhe kontratat kur bëhen të merren edhe inçizimet e atyre çka kanë ofrue dhe të përfshihen në kontratë. Ne e dijmë se KEDS-i, është një kompani që furnizon me energji elektrike, por këtë mundësi ia kisha kushtëzuar me të gjitha fshatrat ku largpërçuesit të cilët nuk kanë fuqi të mjaftueshme të energjisë të përmirësohen dhe kjo pronë që po jepet ta prekë qytetarin.

Kryesuesi - Atë ditë kemi rënë dakord që DSHPE-ja, me i dërgue për ato 4 fshatra që kanë mbetë në gjysmë në mënyrë që me përfundue projekti

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për 1 votë kundër dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesi Kompania kosovare për distribuimin dhe furnizim me Energji Elektrike SH.A. "KEDS".

Kryesuesi – Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënienn në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë, N.T.SH. "Diari".

Enver Gashi –Ne jemi për aprovim.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për aprovim.

Fatos Kurshumlija - Unë do të abstenoj.

Nora Preniqi – Edhe unë do të abstenoj.

Nazmi Gashi - Unë jam për aprovim.

Muhamet Mustafa - Mua, më intereson se këto 2 kompani N.TSH "Tre" dhe "Diari" kanë kërkuar të njejtën parcelë 12416, dhe këtu po e shohë se iu ka ndërrue Diarit 12409, a është biseduar me të dhe a pajtohet ai të investoj, do të thotë a është njoftuar ai për këtë çështje.

Kryesuesi - Përgjegjet po, në debat publik i kemi ndarë parcelat.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesi N.T.SH. "Diari".

Kryesuesi - Paraqet Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë, ofertuesi "Bermas Therm" SH.P.K.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovim.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për aprovim të këtij propozimvendimi.

Fatos Kurshumlija - Unë do të abstenoj.

Nora Preniqi – Unë jam për aprovim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për dhe 1 votë abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesi Bermas Therm SH.P.K.

Kryesuesi – Paraqiti Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënienn në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë, ofertuesi Bimer Group SH.P.K.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovim.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për aprovim.

Fatos Kurshumlija - Unë do të abstenoj.

Nora Preniqi – Unë do të abstenoj.

Nazmi Gashi - Unë jam për aprovim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesi Bimer Group SH.P.K.

Kryesuesi – Paraqiti Propozimvendimin e Kryetarit të Komunës për dhënienn në shfrytëzim afatgjatë të parcelave në ZK në LLazarevë, ofertuesi A-D-E Group SH.P.K.

Enver Gashi – Ne jemi për aprovim.

Hysni Mjeku – Edhe ne jemi për aprovim.

Fatos Kurshumlija - Unë do të abstenoj.

Nora Preniqi – Edhe unë do të abstenoj.

Nazmi Gashi - Unë jam për aprovim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 11 vota për dhe 2 vota abstenim e aprovuan Vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë, ofertuesi A-D-E Group SH.P.K.

Pika e 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DEFZH-ja, nr.IV-360, të dt.24.09.2020, për aprovimin e vendimit të tatimit në pronë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për e aprovuan Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga DSHPE-ja, për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit komunal nr.I-67, të dt.25.04.2019.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 14 vota për e aprovuan Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit nr.I-67, të dt.25.04.2019, të Komisionit për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale me anëtarin Hamit Mjeku në vend të Ibush Mjekiqit.

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me kërkesat të cilat janë shqyrtuar në KPF, dhe janë dërguar në Drejtoritë përkatëse për shqyrtim.

Neve, na ka ardhë edhe një kërkesë nga Banush Mirena, i cili kërkon ndihmë me 1, ose 2 kamion zhavorr për rregullimin e një rruge poshtë varrezës.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në DSHPE.

Po ashtu, e kemi edhe raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019. Ne në muajin e kaluar e kemi shqyrtue dhe ky raport ka qenë me performancën më të mirë në Komunën tonë, sa i përket menaxhimit të parasë publike.

Pika e 9 e rendit të ditës

Shaip Paloja – Rreth performancës dua një sqarim nga Kryetari, rreth çështjes që Ministria, ua ka heqë 5 milion Komunave.

Kryetari – Sa i përket performances, është fat i mirë se Komuna e Obiliqit, është në mesin e 3 Komunave më transparente, më e suksesshme me pëlqim të buxhetit dhe mbledhjeve të Kuvendit. Fondi është 5 milion e 200, janë 3 donatorë, që në këtë rast është Norvegjia, Zvicra dhe Holanda dhe ne si Komunë jemi përfitues në bashkëpunim me Ministrinë e pushtetit lokal. Ne si Komunë jemi edhe përfitues të bonusit që pastaj është ndarë për kokë banori, por në këtë rast është për herë të parë që Komuna jonë në nivel të institucioneve qëndrore dhe lokale renditet e treta, që është një sukses i jashtëzakonshëm. Pastaj ka ndodhë problemi se ka pasë 3 ankesa të Komunave, të cilat nuk i ka shqyrtue Ministria e pushtetit lokal dhe në Kuvendin e Asociacionit të Komunave që e kemi pasë është diskutue dhe një nga kërkesat e rekomandimeve ka qenë nga Kryetari i Elez Hanit. Ne i kemi votuar të gjitha vendimet që kanë dalë atë ditë në Kuvend, që si duket nuk i ka pëlqye shumë Ministrisë dhe në mënyrë të njëanshme është ndërprerë marrëveshja me donatorët. Ne prapë i kemi falenderuar dhe dje kemi pasë edhe prononcim nëpër media dhe institucione qëndrore. Sot kemi kërkuar takim me Kryeministrin që këto mjete financiare mos të hiqen nga fondi i Komunave sepse nuk është hera e parë që luftohet për performancë. Po ashtu, është kërkesë që të trajtohen ato 3 ankesa të Komunave dhe të vazhdohet më tutje. Unë shpresoj se pas takimit me Kryeministrin, do ta japim një deklaratë të faqja e Asociacionit dhe pas komunikimit që e kemi të vazhdueshëm me Kryetarë, shpresojmë se mjetet do të rikthehen, por mbi të gjitha edhe nëse, nuk rikthehen ne e kemi zënë vendin e tretë.

Hysni Mjeku – Pyeti se kur pritet të asfaltohet rruga Palaj-Grabofc.

Kryetari – Përgjegjet se është në proces dhe besoj se shumë shpejt punimet do të përmbyllen.

Muhamet Mustafa – Është kërkesë e shumë banorëve të fshatit Breznicë, që në fshatin Stanovc, të vendoset një shenjë treguese sepse si dihet se sa ka qenë magjistrale ka qenë shenja treguese, por kur është punuar autostrada, nuk është vendos. Ne kemi disa raste që kanë shkue deri në Vushtrri dhe nuk kanë mund me qëllue rrugën, fjala është për miqtë tonë. Unë e di se ndoshta Komuna, nuk ka kompetenvë me vendosë, por mundet me ia përcjellë kërkesën Ministrisë.

Kryetari – Ne do ta provojmë dhe tek e fundit nëse, nuk e vendosin ata e vendosim vetë atë shenjë. Ju njoftoj se sa i përket pandemisë në Komunën e Obiliqit, fatmirësisht tani vetëm 5 vetë, i kemi të infektuar. Deri më tani janë kryer 393 monstra nga Komuna jonë, 183 kanë rezultue pozitiv dhe nga ata fatkeqësisht 14 kanë ndërruar jetë. Sipas informatave që i kemi nëpër shkolla, nuk e kemi asnjë të prekur, kështu që mësimdhënësit dhe Drejtoria janë shumë aktiv në këtë drejtim

Rexhep Zeka – Ju njoftoj me një lajm të mirë se mësimdhënësit aktual i kanë marrë pagat jubilare.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri